



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 48**

Datë: 23. 07. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvic, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

#### **1. Hyrje: Kryesues i mbledhjes, z. Alim Rama anëtarë i KQZ-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.46 dhe 47/2021.

#### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

#### **3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të subjekteve politike.

#### **4. Këshillat e KQZ-së:**

- Këshillit për Buxhet dhe Financa:

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve për periudhën janar-qershor 2021 të KQZ-së,
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për periudhën janar- qershor 2021 të KQZ-së.

**Këshillit për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i nominimit për anëtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Gjilanit për zgjedhjet lokale 2021.

**5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik.**

**6. Të ndryshme**

**1. Hyrje: z. Alim Rama, kryesues i mbledhjes:**

**Alim Rama:** E fillojmë mbledhjen e 48-të, dhe në mungesë të kryesuesit sipas rotacionit, unë e udhëheqi këtë mbledhje. Kemi pasur nga z. Kurteshi një propozim s'i pika e 6-të..."Njoftim për konstituimin e Komitetit të Auditimit"...! A ka vërejtje ?

Nëse jo, kush është për këtë rend dite...?

Miratohet rendi i ditës.

Në vazhdim, me një votë abstenimi ( Alim Rama), miratohen procesverbalet e mbledhjeve të KQZ-së nr. 46 dhe 47/2021.

**2. Aktivitete e SKQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Raportin e keni pasur, por do të ndalem tek aktivitetet kryesore ! Para se të filloj, ju njoftoj se në këtë periudhë, divizioni i shërbimit të votuesve, me qëllim të informimit të votuesve për qendrat e votimit, ka dërguar ka dërguar të dhënat për shtypjen e kartolinave dhe tekstin njoftues. Janë shtypur dhe dërguar përmes postës, gjithsej 65,525 kartolina për këto kategori votuesish: Për votuesit e rinj, që do të votojnë për herë të parë me datën 17 tetor 2021; Për votuesit që në zgjedhjet parlamentare të datës 14

shkurt 2021 që kanë votuar me kusht; Për votuesit që kanë ndërruar adresë prej zgjedhjeve të fundit (14 shkurt 2021) dhe që rrjedhimisht ju ndërrohet edhe qendra e votimit.

Këto kategori të lartpërmendura, tha z. Ahmeraj do të kenë mundësi që individualisht përmes dërgesës postare të njoftohen për qendrën e votimit që i'u është caktuar, dhe pastaj, eventualisht të kërkojnë ndërrimin e qendrës së votimit më të përshtatshme (më të afërt) për ta, përgjatë periudhës, që përfundon me datën 7 shtator 2021.

Në vazhdim të raportit mbi aktivitetet e Sekretariatit, Ahmetaj tha se në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka shpërndarë në të gjitha Komunitet Listën Preliminare të Votuesve për t'i publikuar nëpër Qendra të Votimit dhe tek zyrat e KKZ-së. Listat Preliminare të Votuesve janë përgatitur nga shërbimi votues, duke i printuar për secilën Qendër të votimit për secilën Komunë.

Gjithashtu, është publikuar lista preliminare e votuesve në ueb faqen e KQZ-së, ku votuesit do të kenë mundësi që përmes numrit personal të shikojnë se në cilën qendër të votimit janë caktuar që të votojnë dhe gjithashtu përmes kësaj platforme online të paraqesin kërkesën për ndërrimin e qendrës së votimit.

Përmes këtij raporti, më poshtë janë dhënë rezultatet e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, prej datës kur ka filluar (10 korrik 2021) deri me datën 22 korrik 2021, në orën 18:00.

Në raport, është paraqitur raporti i rezultateve të aplikimit të regjistrimit të votuesve.

Gjithashtu, shërbimi i votuesve u ka dërguar njoftim se kërkesat e tyre janë aprovuar. Njoftimi përmban edhe detyrimin ligjor, të përcaktuar sipas Rregullës Zgjedhore nr. 03/ 2013 Votimi jashtë Kosovës, neni 3.8, se “të gjithë votuesit që u janë aprovuar kërkesat për regjistrim për votim jashtë Kosovës dhe që janë shtetas të Republikës së Kosovës në regjistrin qendror civil, emrat e tyre do të largohen nga lista e votuesve brenda Kosovës, që përdoren në vendvotime”.

**Arianit Elshani**, pati pyetje rreth imellave dhe formularëve që në mbledhjet e kaluara është kërkuar që, të gjithë aplikuesve në zgjedhjet e kaluara pavarësisht a kanë qenë të suksesshëm apo jo, tu dërgohet kërkesa për aplikim...A është bërë kjo, dhe pyeti po ashtu edhe rreth faktit se a, është bërë një plan operacional `lidhur me udhëzimin për verifikim në bazë të mostrës...Kur do të fillohet me këtë plan operacional...? Si dhe qysh do ta zbatoni këtë plan ?

Florian Dushi, pati vërejtje rreth raportit të aplikimit të votuesve nga jashtë. Domehënë, rreth klasifikimit të tyre në aspekt të validitetit të tyre, ose jo...! Dushi, kërkoi që Sekretariati ta njoftojë KQZ-në me një

raport se çka ka ndërmarrë MPB rreth Ekstraktit Civil, gjithnjë në shërbim të saktësisë dhe vërtetësisë së Listës Votuese...

**Burim Ahmetaj:** E para, kjo që potencoi z. Dushi, jemi në përgatitje të konkluzioneve që, janë drejtuar edhe te ARC rreth Listës Votuese... NE, do të jemi të informuar ë saktë nga ARC, dhe ne do t'ju njoftojmë...

**Alim Rama:** Kur do të na njoftoni...?

**Burim Ametaj:** Besoj në mbledhjen e radhës...

**Sami Kurteshi:** Me të drejtë u hap çështja...Ne, kemi diskutuar dhe, një prej vendimeve është që KQZ e marrë përsipër që do t'ia dërgoj një kërkesë ARC-së që, një ditë para zgjedhjeve KQZ ta merre një Listë të Rifreskuar...

Ata të ARC-së thanë se, kurrë nuk u është kërkuar kjo, prandaj tu dërgohet një kërkesë...

**Burim Ahmetaj:** Imellat, por verifikohen dhe gjatë javës të gjithë votuesve nga jashtë do tu dërgohet imelli që tu jepet mundësia të gjithë të votojnë nga jashtë vendit...

Rreth udhëzimit administrativ, jemi në përgatitje e sipër...Divizioni i Shërbimit Votues, është në përgatitje e sipër, ku do të përfshihen disa komponenta teorike dhe praktike...

**Sami Kurteshi** tha se, është mbajtur takim edhe me PZAP-në, dhe se është diskutuar edhe rreth asaj se asnjë qëndrim që ka të bëjë me të drejtat e votuesve, nuk duhet të abuzohet dhe se komunikimi duhet të jetë i saktë, sidomos në aspektet kohore. Në mes të dy institucioneve, duhet të ketë më shumë relacione bashkëpunimi, sidomos rreth procedurave që lidhen me aspektet e të drejtave, qartësisë në bashkëpunim etj.

Pastaj, unë kam ngulur këmbë disa herë se aplikimi on – linë, është gjë normale dhe se, ka diskriminime...Pra, aplikimi online- të jetë i barabartë, si me qytetarët brenda vendit, dhe njëjtë edhe për ata që jetojnë jashtë Kosovës...

**Alim Rama,** tha se, e përkrahë këtë shpjegim të z. Kurteshi...

**Florian Dushi,** tha se për korrektësi, duhet ti shohim format që e lehtësojnë votimin, por ideja e ligjvënësit gjithmonë ka qenë me e mbrojtje integritetin e procesit zgjedhor...Po, unë mendoj se, subjektet tona duhet të fillojnë definitivisht të merren me çështje e reformimit të sistemit zgjedhor, sepse ka procedura të vjetruara...

**Alim Rama**, tha se ligji për zgjedhjet është dogmatik, por procedurat mund të lehtësohen nëse ka vullnet...

**Florian Dushi**, tha se procesi mund dhe duhet të thjeshtësohet, pavarësisht interpretimeve politike dhe juridike...

Në këtë temë, diskutuan përsëri: **Sami Kurteshi**, i cili tha se në procedura kemi të bëjmë me çështje, kryesisht teknike...

Anëtarët e KQZ-së, shqyrtuan dhe eksploruan mendimet, idetë dhe interpretimet e tyre, kushtimisht në favor të gjetjes së moduleve apo teknikave që, e lehtësojnë procesin e votimit...

### **3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të subjekteve politike.**

**Yll Buleshkaj**: Zyra, është duke zbatuar mandatin e saj sipas kompetencave ligjore ndërsa disa nga aktivitetet që ka kryer Zyra në periudhën raportuese janë si në vijim. E para, nuk kemi pasur aplikime shtesë për certifikim, nga raporti i fundit... E dyta, është se partia politike “Lista Serpska” ka mbajtur kuvendin e saj, dhe ka bërë zgjedhjen e kryetarit...

Kemi pranuar edhe një aplikacion për regjistrim të një partie të re politike dhe se, jemi në shqyrtim këtij subjekti me emrin “Forca e Diasporës”, me qendër në Prishtinë. Me 21 korrik 2021, Zyra ka pranuar aplikacionin e plotë të iniciativës për regjistrim dhe se, si bartës është z. Mehmet Manovi. Zyra është në shqyrtim të dokumentacionit ndërsa lista me përkrahësit e kësaj e ekstraktuar nga aplikacioni, i është dorëzuar Zyrtarit të Lartë të Databazave për verifikim kundrejt Listës së Votuesve, i cili ka identifikuar disa mungesa.

Zyra, po ashtu tha z. Buleshkaj, rekomandon që KQZ të certifikoj iniciativë “Bashkë për Istogun” nga komuna e Istogut lista “Goxo” për komunën e Ferizajt. E para, do të konkurroj edhe për kryetar të Istogut dhe për asamblenë komunale, dhe e dyta, vetëm për asamble komunale.

Anëtarët e KQZ-së, veç e veç, miratuan rekomandimet e ZRPP-së.

### **4. Këshillat e KQZ-së:**

## **1. Këshillit për Buxhet dhe Financa:**

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve për periudhën janar-qershor 2021 të KQZ-së:**

**Arianit Elshani:** Para jush e kemi raportin e shpenzimeve të derivateve për periudhën janar-qershor 2021. Ne, kemi diskutuar në këshill, ne kemi dalë edhe me disa rekomandime dhe se, kemi kërkuar që Këshilli Ligjorë të shqyrtoj dhe analizojë përdorimin e veturave zyrtare...!

**Shpenzimet, janë të evidentuara...**të argumentuara...Kërkojmë që, në mënyrë urgjente kjo të diskutohet edhe në KQZ, dhe të vendosen parimet e shfrytëzimit të veturave...

**Unë, meqë ka kaluar në këshill, rekomandojmë që kuy raport të miratohet.**

**Alim Rama,** dha vërejtjet e tij sidomos, për mungesën e evidencave rreth përdorimit dhe shfrytëzimit të automjeteve të KQZ.

**Z. Rama,** tha se nuk e voton këtë raport...

Në këtë pikë, diskutoi edhe Sami Kurteshi që tha se, ne duhet të marrim një qëndrim përfundimtarë rreth kësaj çështjeje...Ndërsa, **Ibrahim Selmanaj,** tha se të mos ndalemi te detajet por, unë personalisht kam dilema se, çfarë pozicioni duhet marrë ndaj votimit të raportit...

**Arianit Elshani,** tha se përkundër të gjithave, këshilli kërkon miratimin e raportit...

**Alim Rama,** tha se Sekretariati nuk ka qenë në gjendje që plotësimet e evidencave të atyre që i shfrytëzojnë veturat, të shënohen apo pasqyrohen me kohë... Vërejtja ime është se, nuk jam bindur që të gjitha kilometrat e shfrytëzuar, janë përdorur për nevojat e KQZ-së...

### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për periudhën janar- qershor 2021 të KQZ-së:**

**Arianit Elshani:** Ne, e kemi miratuar këtë raport pas shqyrtimit, dhe se aspektet e raportit janë të **pasqyruara në tabelë... Shpenzimet, janë deri në 50.3 dhe se, ne rekomandojmë për aprovim...**

**Në fund, u tha se raporti ka kaluar në këshill pa vërejtje dhe ne, rekomandojmë për miratim...**

**Raporti, unanimisht u aprovua...**

### **3. Këshillit për Operacione Zgjedhore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i nominimit për anëtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Gjilanit për zgjedhjet lokale 2021:

**Alim Rama:** Këshilli, ka shqyrtuar nominimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Gjilanit për zgjedhjet lokale 2021 nga Lëvizja “Vetëvendosje”! Në mënyrë unanime, këshilli pas shqyrtimit të kërkesës, ka rekomanduar që Filloreta Idrizi të emërohet anëtare e KKZ-së në Gjilan, dhe n rekomandojmë për miratim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim .

### **5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik.**

**Fazli Stollaj**, tha se para vetës e keni raportin për aktivitetet që i ka ndërmarrë KMIP-k dhe se, janë mbajtur dy mbledhje më 19 dhe 21 korrik, ku janë shqyrtuar dhe miratua produktet, kryesisht lidhur me informimin e qytetarëve për aplikim dhe votim jashtë Kosovës.

Janë shqyrtuar dhe miratuar produktet: përmbajtjet e videospotit, dizajnet, mediaplanet, përzgjedhjen e radiove dhe portaleve etj.

Më 21, janë aprovuar videot dhe radio spotet, posterit dhe, në fazat në vijim do të shqyrtohen dhe miratohen produktet sipas planit operacional...

**Rifat Krasniqi**, tha se ju falënderoj për përkrahjen që në 5 komuna Fletëvotimet të shtypen në gjuhën turke...si dhe spoti në gjuhën turke...

**Alim Rama**, tha se të gjitha materialet e tjera të IP-së, do të prodhohen në gjuhët e komuniteteve...

Në këtë pik, diskutuan edhe: Sami Kurteshi, Gordana Llaban, Florian Dushi, Fazli Stollaj, Alim Rama etj.

### **6. Të ndryshme**

**Sami Kurteshi**, e informoi KQZ-në se e kemi rrumbullakuar procesin, domethënë konstituimin e Komitetit dhe se, javën e ardhshme do ta caktojmë takimin e parë...Të tjerat...!

Lidhur me këtë pikë, diskutoi edhe auditori i brendshëm i KQZ-së Sylejman Gashi, rreth bashkëpunimit dhe organizimit të mbledhjes së parë të Komitetit...

Do t'ju mbajë të informuar...